



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

Legjislatura V

Sesioni pranveror (*I*)

Kryesia e Kuvendit

P-081

Prishtinë, më 16 janar 2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 JANAR 2017**

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit dhe të Sesionin pranveror.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

\* \* \*

### **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 19 dhjetor 2016 dhe 7 janar 2017**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 19 dhjetor 2016 dhe 7 janar 2017.

### **2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 19 janar 2017, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë,*
8. *Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,*
9. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

Kryesia e Kuvendit lidhur me pikën 9 të lartshënuar të rendit të ditës nxori edhe këtë:

## Përfundim

1. Grupet parlamentare të Kuvendit duhet që deri në seancën e radhës, më 19 janar 2017, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtarit në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP i LVV-së, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP Lista Serbe, 1 anëtar; GP Nisma, 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

\* \* \*

### 3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

*1. Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### Përfundim

1. Projektligji nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si komision funksional që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*2. Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### Përfundim

1. Projektligji nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158 t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si komision funksional që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*3. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, i hartuar nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

### **Përfundim**

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqet mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një muaji nga dita e pranimit.

*4. Procedimi i Projektligjit për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, i hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

### **Përfundim**

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin nr. 05/L-138 për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një muaji nga dita e pranimit.

*5. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Programin e lartshënuar, nxori këtë:

### **Përfundim**

1. Programi legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017 t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që mbi bazën e Programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe të propozimeve të veta t'i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2017 deri më 27 janar 2017.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që në bazë të Programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe planeve të punës së komisioneve parlamentare ta hartojë Propozim-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 deri më 2 shkurt 2017, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet Seancës plenare për miratim.

*6. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2016*

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2016, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

7. *Kërkesa e deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë nënshkrues, për debat parlamentar me temë: “Respektimi i të Drejtave të Njeriut”*

Kryesia e shtyu kërkesën e lartshënuar për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

8. *Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbajtjen e Samitit të kryetarëve të komisioneve për Punë të Jashtme të vendeve të BE-së dhe Ballkanit, si dhe mbulimin e shpenzimeve për organizimin e këtij samiti, i cili planifikohet të mbahet në Prishtinë, nga 19-22 shkurt 2017*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbajtjen e Samitit të kryetarëve të komisioneve parlamentare për Punë të Jashtme të vendeve të BE-së dhe Ballkanit, i cili do të mbahet në Prishtinë prej 19-22 shkurt 2017.

2. Të gjitha shpenzimet për organizimin e Samitit të lartshënuar në pikën 1 (një) të këtij vendimi, sipas kërkesës nr. 05/2986/DO-1518, datë 29 dhjetor 2016, do të mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. *Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

1. Anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Faton Topalli, Ali Sadriu, Fikrim Damka, Naim Fetahu, Abdyl Ymeri, Bali Muharremaj, Enver Hoti, Synavere Rysha dhe Hajdar Beqa u lejohet udhëtimi në Shqipëri prej datës 19 - 22 janar 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

10. *Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar në Kore*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

1. Miratohet kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar - pjesëmarrja në Samitin e Katërt Botëror për “Paqe, Siguri dhe Zhvillim Njerëzor”, i cili do të mbahet në Seul (Kore), prej 31 janar deri më 6 shkurt 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, si dhe avanci në shumë prej 1 500 euro për ish-kryetarin e Kuvendit, si dhe për asistentin e tij, Skënder Reçica, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

*11. Kërkesa e disa deputetëve të Kuvendit për ndërtimin e Qendrës për Takimet “Lutjet e Mëngjesit”*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e Grupit të deputetëve për sigurimin e hapësirës për ndërtimin e Qendrës për Takimet “Lutjet e Mëngjesit”, si dhe mundësinë, në pajtim me legjislacionin përkatës, për dhënien në shfrytëzim të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmë dhe Kuvendit t’ia paraqesë propozim-vendimin për miratim.

*12. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri*

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën e realizuar në Shqipëri, nga 5 - 6 dhjetor 2016.

*13. Njoftimi i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Parlamentin Evropian në Strasburg*

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Parlamentin Evropian në Strasburg (Francë), nga 12 - 14 dhjetor 2016.

*14. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel*

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, nga 28 - 29 nëntor 2016.

*15. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Suedi*

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Suedi, nga 12-16 dhjetor 2016.

*16. Njoftimi i deputetes Valdete Bajrami, kryesuese e Grupit për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Letoni*

Kryesia u njoftua me raportin e deputetes Valdete Bajrami, kryesuese e Grupit për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën e realizuar në Letoni, nga 12 - 15 dhjetor 2016.

#### **4. Pikat shtesë:**

*1. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të ekspertit për hartimin e raportit dhe rezolutës për takimin e Komisionit të Ekonomisë, Infrastrukturës dhe Energjisë në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### **Vendim**

Miratohet kërkesa e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Muhamet Mustafa, për mbulimin e shpenzimeve në shumën prej 1 800 (një mijë e tetëqind) euro, bruto lidhur me angazhimin e një eksperti për hartimin e raportit dhe Rezolutës për takimin e Komisionit të Ekonomisë, Infrastrukturës dhe Energjisë në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, që do të mbahet në Kroaci në muajin mars 2017.

*2. Kërkesa e deputetit Visar Ymeri për lejimin e udhëtimit zyrtar në Seul (Kore)*

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, e konfirmoi vendimin nr. 05-V-472, datë 11 janar 2017, si në vijim:

#### **Vendim**

1 Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Visar Ymeri, i lejohet udhëtimi zyrtar në Seul (Kore), prej 1- 5 shkurt 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe të ushqimit për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet për vizë dhe mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

*3. Përgatitjet për shënimin e 9-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, mori këtë:

#### **Vendim**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të 9-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës do të mbajë seancë solemne më 17 shkurt 2017, në orën 10:00.

2. Të gjitha shpenzimet lidhur me aktivitetet që do të organizohen me rastin e shënimit të 9-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*